VENDIM
Nr. 776, datë 19.11.2014

PËR DISA TË DREJTA TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT, NË MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, pika 5, 34, pika 5, 35, pika 3, e 36, pika 1, të ligjit nr. 70/2014, "Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme", dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, kur caktohet në punë jashtë vendbanimit të tij/të saj, përfiton pagesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, si më poshtë vijon:

a) nga 36 km deri 60 km, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë/muaj;

b) nga 61km deri 100 km, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë/muaj;

c) nga 101 km deri 150 km, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/muaj;

ç) nga 151 km deri 200 km, në masën 14 000 (katërmbëdhjetë mijë) lekë/muaj;

d) mbi 200 km, në masën 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë/muaj.

Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të Shërbimit, që nënkupton sistemimin me banesë në territorin që përkon me juridiksionin e njësisë strukturore të Shërbimit, në nivel vendor (në rrethin qendër qarku), ku punonjësi është caktuar.

2. Kur punonjësi i Shërbimit caktohet në punë jashtë vendbanimit të tij/të saj dhe, për këtë shkak, bashkëshortja/i ndërpret marrëdhëniet e punës, në rast të pamundësisë së punësimit, i jepet një pagesë në emër të bashkëshortes/bashkëshortit, deri në çastin e punësimit, por jo më shumë se 15 vite, në masën:

a) 50 % të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune nga 3 (tre) muaj deri në 1 (një) vit;

b) 100 % të pagës mujore minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 1 (një) vit deri në 10 (dhjetë) vjet;

c) 100 % të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por jo më shumë se 150 % të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi në punë mbi 10 (dhjetë) vjet.

Paga mesatare mujore e bashkëshortes/it indeksohet me rritjen e pagave sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

3. Punonjësit të Shërbimit për rezultate të larta në punë, për shkak të kryerjes së detyrave e shërbimeve të veçanta në realizimin e veprimtarive të Shërbimit, si dhe në luftën kundër korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të ligjit, i jepet shpërblim deri në 1 (një) pagë mujore në vit. Ky shpërblim përballohet nga fondi i veçantë dhe mund të jepet përgjatë të gjithë vitit kalendarik.

4. Personeli i Shërbimit gëzon të drejtën e pushimit vjetor të pagueshëm, si më poshtë vijon:

a) Për personelin operacional me grada, pushimi vjetor i pagueshëm jepet i përshkallëzuar sipas niveleve:

- 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të lartë drejtues;
- 40 (dyzet) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të mesëm drejtues;
- 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të parë drejtues;
- 30 (tridhjetë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit zbatues.

b) Për personelin pa grada, pushimi vjetor i pagueshëm jepet i përshkallëzuar sipas niveleve:

- 40 (dyzet) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të mesëm drejtues;

- 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike për punonjësit e nivelit të ulët drejtues dhe për punonjësit e nivelit ekzekutiv.

c) Për personelin mbështetës, pushimi vjetor i pagueshëm jepet 4 (katër) javë kalendarike.

Punonjësi i Shërbimit përfiton dhe të drejtën e pushimeve të pagueshme ose jo, në përputhje me aktet ligjore dhe Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

5. Punonjësi i Shërbimit trajtohet me pushim ose pagë shtesë për mbikohën normale të punës, në mbështetje të akteve ligjore në fuqi.

6. Punonjësi i Shërbimit trajtohet me veshmbathje një herë në vit, në masën e 1 (një) page mujore të vendit të punës.

7. Punonjësi i Shërbimit, që përfiton sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi, nënkupton punonjësit e përcaktuar në pikën 1, të nenit 21, të ligjit nr. 70/2014, "Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme", duke përjashtuar punonjësit e shërbimeve mbështetëse.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

9. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm që duhet të paraqesë punonjësi i shërbimit, që përfiton sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi.

10. Ngarkohet ministri i Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama